



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:038570

Datë: 06.09.2021

Numri i dokumentit: 02145311

PA1.nr.1014/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me sekretaren juridike, Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit J.P., nga Prishtina, për shkak të veprës penale dhuna në familje nga neni 248 par. 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit J.P., av. Bedrie Rexhepi, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.768/2020, të datës 23.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.09.2021 mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit J.P., av. Bedrie Rexhepi, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.768/2020, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.768/2020, është shpallur fajtor i akuzuari J.P., për shkak të veprës penale dhuna në familje, nga neni 248 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 3(tri)viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër të re penale, si dhe dënim ime gjobë në shumën prej 300(treqind)Euro, të cilin dënim i akuzuari është obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditëve, e jo më larg se 3(tre)muaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari mund ta paguaj deri në tri këse mujore në afat prej 3(tre)muajve, por jo më shumë se 3(tre)muaj, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet, atëherë gjykata në kuptim të nenit 43 par.3 të KPK, do të zëvendësoj në dënimin me burgim, duke llogaritur një ditë burg, me nga 20Euro.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 30Euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërinë së aktgjykimit.

E dëmtuara XH.G., për realizmin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit J.P., av.Bedrie Rexhepi, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.1030/2021, të datës 10.08.2021, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit J.P., av.Bedrie Rexhepi, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit J.P., av.Bedrie Rexhepi, aktgjykimin e ankimuar, shkresat e tjera të lëndës, si dhe propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit J.P., av.Bedrie Rexhepi, nuk është e bazuar.

Meqenëse aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktvendimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit J.P., av.Bedrie Rexhepi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, nuk i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese sikurse janë, se i akuzuari J.P., e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, se është penduar thellësisht për krerjen e kësaj vepre penale, se i akuzuari pas kryerjes së kësaj vepre penale shpirtërisht është lënduar, se ka shpreh keqardhje dhe ka qenë korrekt gjatë të gjitha fazave të procedurës, se i ka normalizuar raportet me bashkëshorten e vet, se ka theksuar se nuk ka pasur dashje që ta kryen këtë vepër penale, se nga martesë dhjetë vjeçare kanë tre fëmijë, se është i gjendjes së varfër ekonomike, andaj po të ishin vlerësuar në masë më përmbajtësore këto rrethana me siguri që vendimi për dënimin do të ishte më i butë.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, për veprën penale e cila i vihet në

barrë, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPK, si rrethana lehtësuese ka vlerësuar faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është penduar dhe ka shpreh keqardhje për veprën e kryer, kurse ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese nga të cilat ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, kurse nga ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit J.P., av. Bedrie Rexhepi, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1014/2021, të datës 06.09.2021

Sekretarja juridike,
Fitnete Hoti

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri